

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E HËNË 31 TETOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Reforma administrative territoriale e vitit 2014 ishte pa asnjë dyshim reforma më e rëndësishme e ndërmarrë ndonjëherë në qeverisjet vendore dhe ky komision dhe puna e tij vërtetoi edhe një herë domosdoshmërinë e kësaj reforme. Sigurisht, realizimi i kësaj reforme ka qenë pjesë e programit të punës së Partisë Socialiste në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 për të treguar edhe një herë angazhimin e qeverisjes socialiste dhe të Kryeministrit Edi Rama, i cili në krye të herës i ka dhënë rëndësinë e duhur pushtetit vendor dhe ka vijuar më tej me monitorimin e kësaj reforme në këta 7 vjet dhe, sigurisht, do të vijojë ta bëjë këtë jo vetëm për mbarëvajtjen e punës së këtij komisioni, por edhe më tej.

Vizionet dhe objektivat e reformës ishin shumë ambicioze, dhe kjo duhet thënë. Megjithatë, ato u realizuan, pavarësisht dy mandateve atipike të pushtetit vendor. Reforma territoriale ka prodhuar impakt të dukshëm pozitiv në të gjithë vendin dhe, përtej diskutimit prej ditës së parë në komision, kur reforma territoriale u blatua vetëm me negativitet, sigurisht, duhet të bëjmë opozitë, por ju e dëgjua edhe parafolësen, e cila në çdo moment foli vetëm për dështim dhe për mosrealizim të objektivave, megjithatë të gjithëve na gjykojnë qytetarët dhe shifrat.

Pak më parë u tha se ky komision pati më shumë se 42 dëgjesa me përfaqësues nga shoqëria civile, u ftuan 12 përfaqësues nga shoqëria civile, 12 përfaqësues nga bota akademike, përfaqësues të pushtetit qendror e vendor dhe, sigurisht, u dëgjua një zë i pavarur nga zëri i parlamentarit, i cili, sigurisht, do të kishte një qasje më politike. Nga të gjitha këto dëgjesa dhe nga perceptimi mbizotërues i aktorëve, duke përfshirë këtu edhe organizatën ndërkombëtare, në veçanti OSBE-në me një raport të dedikuar për financat dhe mbarëvajtjen e punës me taksat e ndara, rezultoi se baltosja negative nuk është argumenti që mbizotëron në rezultatin e kësaj reforme.

Reforma Administrative - Territoriale ishte e domosdoshme, ashtu siç e thashë pak më parë, konsiderohet se ka arritur sukses të dukshëm në drejtim të demokracisë lokale, të autonomisë së vetëqeverisjes, si dhe në përmirësimin e ndjeshëm të performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore. Konsolidimi i njësive është një proces i vazhdueshëm, i cili kërkon mbështetje të mëtejshme dhe angazhim të të gjithë aktorëve, si atyre vendas, edhe atyre ndërkombëtarë. Për një reformë kaq të rëndësishme, 7 vjet, siç e thashë pak më parë, mund të mos jenë të mjaftueshme, megjithatë, është e mjaftueshme për të parë disa shifra e fakte.

Do të filloj me financat, konsolidimin financiar, sepse kjo jo vetëm është një fushë shumë e prekshme, por është një nga objektivat kryesorë që ka pasur kjo reformë. Rritja e buxhetit në tërësi për pushtetin vendor shkon nga 2,1% e PBB-së që ishte në vitin 2014, pra, para reformës, në 3,2% të PBB-së në vitin 2021. Shpenzimet totale të pushtetit vendor janë rritur nga 34 miliardë lekë në vitin 2015, në 57 miliardë lekë në vitin 2021, ose 67,6% më shumë. Bashkitë, në aspekt të personelit në aparat dhe në administratë kanë 35% më pak punonjës se në vitin 2014. Zoti Sula, mund të qëndroni deri në fund dhe të dëgjoni argumentimin.

Po, aparati është 35% më pak, por po të keni durimin për të qëndruar, do t'i kthehem përsëri, ai ka 76% më pak numër këshilltarësh, pra, nga 6500 këshilltarë, shifra shkon në 1500. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë rritur mbi dy herë, me 217%, ose nga 11, 7 miliardë lekë në vitin 2015, në 26, 6 miliardë lekë në vitin 2021. Investimet, që janë komponentë shumë të rëndësishëm dhe të pamohueshëm, në aspekt të zërave të programeve buxhetore, por edhe si infrastrukturë, janë realizuar me mbi 3 herë më shumë se viti i parë i reformës. Për t'iu kthyer debatit të kahershëm në komision, por edhe këtu, jam e bindur që do të ketë diskutime të mëtejshme në raport me numrin e punonjësve. Dua të theksoj se një rol shumë të rëndësishëm që ka pasur kjo reformë për autonominë e qeverisjes vendore, ka qenë decentralizimi i funksioneve.

Janë 5 funksione, të cilat i tha pak më parë edhe zonja Çupi, të cilat kanë lëvizur në përgjithësi nga monitorimi dhe ndjekja e pushtetit qendror në atë vendor. Sigurisht është shumë e rëndësishme të shikohet se si shërbimet e shtuara në pushtetin vendor dhe rritja e të gjitha këtyre investimeve do të shoqërohen edhe me një numër personeli më të rritur në shoqëri, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me shërbimet publike. Këtu kemi disa shifra dhe fakte, të cilat flasin pikërisht për rritjen e numrit, por nuk duhet të bëjmë kakofoni numrash dhe të flasim për totalin. Flitet për një numër rreth 22 000 më shumë, por, në fakt, 10 000 janë vetëm nga transferimi i funksioneve, 5000 nga ulja e numrit të këshilltarëve dhe ka një numër prej gati 5600-6000, të cilët vijnë si rezultat i shërbimeve të rritura. Kjo,

pikërisht, për të mbështetur decentralizimin e funksioneve, por edhe rritjen e numrit të investimeve dhe të shërbimeve që thamë pak më parë.

Nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, vetëm 12 bashki kanë rritur numrin e punonjësve të administratës për vitin 2021 krahasuar me atë të vitit 2014; kanë ulur numri i punonjësve të administratës 49 bashki, ose 70% e tyre në vitin 2021 në raport me atë të vitit 2014. Pra, edhe një herë, nëse të ardhurat janë rritur me mbi dy herë në totalin e bashkive në këto 7 vjet dhe investimet janë rritur me 3 herë, sigurisht që rritja e numrit të punonjësve të shërbimit do të ishte e pranueshme, por jo administrata, e cila shënon një ulje me 35% të numrit të punonjësve.

Një element shumë i rëndësishme në raport me financat mbetet çështja e të ardhurave. Sigurisht reforma administrativo-territoriale nuk ishte i vetmi element i rëndësishëm i marrë përsipër nga qeverisja "Rama" për të çuar përpara suksesin e kësaj reforme, por kjo reformë u shoqërua me disa ndryshime shumë të rëndësishme dhe me ligje shumë thelbësore, të cilat ndihmojnë edhe më tej autonominë financiare. Ne kemi ligjin e vitit 2017, i cili krijon shumë më tepër hapësira dhe instrumente për të rritur të ardhurat në nivelin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Çfarë tregojnë raportet, sidomos ai OSBE-së, i cili u prezantua për të gjithë komisionin?! Ai tregon se përqindja e totalit të të ardhurave të bashkive, apo njësive të vetëqeverisjes vendore mbi totalin e të ardhurave mesatare është 28,8%. Kjo do të thotë se jo të gjitha bashkitë kanë realizuar një rritje të konsiderueshme të përqindjes së të ardhurave të veta nga totali i të ardhurave. Vetëm 7 bashki janë mbi nivelin e 28,8%.

Po të shikojmë strukturën e raportit të OSBE-së, shohim se bashkitë e mëdha dhe të mesme janë ato që kanë realizuar mundësinë e krijimit të një rezultati financiar të suksesshëm, pikërisht, nga instrumentet që ky ligj u jep dhe u mundëson. Por ka bashki të tjera të vogla, të cilat nuk arrijnë dot ta krijojnë këtë mundësi, edhe pse ligji ua lejon, edhe pse dëshira dhe vullneti i kryebashkiakëve dhe i këshillave bashkiakë ekziston. Prandaj, pa dashur të shkoj në përfundimin e raportit, dua ta sjell të gjithë vëmendjen e këtij parlamenti drejt të ardhurave financiare, sepse mendohet të copëtohet më shumë territori dhe të krijohen njësi më të vogla kur ende kemi një numër prej 17 njësish të vetëqeverisjes vendore që këto të ardhura nuk i kanë arritur te mesatarja prej 28,8%, që thashë pak më parë.

Kjo ishte për sa i përket pjesës financiare dhe numrave, por ka edhe më tej. Nga këto dëgjesa dhe nga zëri i pavarur i ekspertëve ka një evidencë të përmirësimit të shërbimeve publike në krahasim me 2014-ën. Kjo nuk do të thotë se çdo gjë është perfekte, ne e kemi diskutuar në komision këtë gjë, madje edhe kemi debatuar. Sigurisht, ka zona ku edhe dëshira për të ofruar shërbim dhe mbulim, sipas kërkesës së

të gjitha qytetarëve, ndonjëherë është e pamundur, jo vetëm në aspektin e burimeve njerëzore, sepse po të shikojmë burimet njerëzore për këto njësi të vetëqeverisjes vendore janë edhe zëri kryesor i shpenzimeve, me gati 45%, por ka edhe mungesë të konsiderueshme cilësie shërbimi dhe personeli në këto zona. Prandaj, ta copëtosh përsëri territorin për të limituar edhe më tej mundësinë e një shërbimi në zona të largëta dhe cilësore, është përsëri një kontradiktë dhe kthim mbrapa te problematikat, që tashmë janë zgjidhur.

Decentralizmi i funksioneve nuk është një proces që ka përfunduar, sigurisht Ministria e Brendshme ka një strategji sektoriale, të cilën e vijon së bashku me ekspertët lokalë dhe ndërkombëtarë, dhe është në përgjegjësinë e saj që ta vijojë më tej, për të parë nëse decentralizmi i mëtejshëm i funksioneve për këto njësi të vetëqeverisjes vendore ka atë që është baza e personelit dhe e burimeve financiare për të vijuar më tej. Hapësira për përmirësim, siç e thashë pak më parë, mbetet, por pyetja që qëndron është: a sigurohet shërbim më i mirë duke e copëtuar territorin? Këtu maxhoranca divergjon nga opozita dhe thotë jo, sepse copëtimi i territorit rrit kostot dhe nuk garanton cilësinë dhe shërbimin që synojnë qytetarët.

Digjitalizimi garanton, njëkohësisht, vijimin e përpjekjes shumë të madhe që ka bërë qeverisja qendrore, duke siguruar që 94% e të gjitha shërbimeve në Republikën e Shqipërisë të realizohen online, por edhe shtrirjen e kësaj qasjeje të shërbimit e pushtetit vendor, për ta sjellë në këtë mënyrë shumë më afër qytetarëve. Çështja e përfaqësimit është po aq e rëndësishme dhe e debatueshme. Të zgjedhurit vendorë përfaqësojnë zgjedhësit; transparenca, llogaridhënia janë shtyllat kryesore ku mbështetet qeverisja e mirë. Ulja e numrit, sigurisht unë e thashë pak më parë, nga 6500 në 1500, nuk i lëviz këto dy shtylla kryesore, ato në themel janë përkatëse të çdo të përzgjedhuri që përfaqëson në atë karrige të këshillit bashkiak partinë politike që e ka përzgjedhur.

Prandaj, përfaqësimi nuk duhet parë si një numër që shkon përgjatë shtrirjes territoriale, por si një rol i rëndësishëm i atij që është përzgjedhur, i partisë politike që bën listën, duke pasur në synim individin, zonat dhe, mbi të gjitha, dy elementet që thashë pak më parë: transparencën dhe llogaridhënien. Qëndrimi sa më afër nevojave të qytetarëve, pavarësisht sa larg apo afër, për çdo anëtar të këshillit bashkiak është një domosdoshmëri dhe në mënyrë absolute nuk duhet ta ngatërrojme analizën dhe performancën e këshillit bashkiak me performancën e reformës territoriale. Prandaj, copëtimi më tej i territorit, duke shtuar anëtarët e këshillave bashkiakë, pa siguruar cilësinë e tyre, llogaridhënien, transparencën e shtuar dhe përgjegjësinë e partive politike për ta siguruar këtë me përgjegjshmëri të

lartë, do të ishte një gabim dhe gjithashtu një kthim mbrapa me problematikat, të cilat përpiqemi t'i zgjidhim në vijim.

Dua t'ju kujtoj këtu disa shifra të reformës, për të cilën bashkëkryetarja, kolegja ime, tha pak më parë se në vitin 2014 u bë me nxitim. Një vit e gjysmë nuk mendoj se është nxitim dhe nuk u bë për një muaj. Ajo reformë është analizuar për gati një vit e gjysmë, janë analizuar shifra. Disa shifra që lidhen me përfaqësimin. Le t'i themi fjalët me peshën që kanë: një vit e gjysmë nuk është nxitim. Shifrat e asaj kohe në raport me përfaqësimin i kam shkëputur dhe i kam sjellë në raport pikërisht për të mbështetur atë çka thashë më lart. Një numër prej 232 nga 373 kryetarë të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe rreth 3000 këshilltarë në nivel vendor përfaqësonin vetëm 19% të popullsisë. Pra, edhe në atë kohë, kur ishin 373 njësi të vetëqeverisjes vendore, numri më i madh i këtyre përfaqësuesve përfaqësonin 19% të popullsisë. Neve na duhet cilësi, përfaqësim dhe rol për t'u shkëputur njëherë e mirë nga numrat.

Një numër prej 18 kryetarësh nga 373 dhe 620 këshilltarësh nga 6500 përfaqësonin 45% të popullsisë. Pra, janë fakte dhe shifra, të cilat flasin vetë, që kthimi te problematikat e zgjidhura me këtë numër këshilltarësh nuk mund të ndodhë me copëtim, por kjo nuk do të thotë se maxhoranca nuk synon rritje të cilësisë së përfaqësimit. Pikërisht, në rekomandimet e lëna në raportin e plotë, por edhe më vonë, që do ta lexoj, një nga pikat e rëndësishme në sugjerimet që i jepet strategjisë për të vijuar më tej, jo vetëm për ndjekjen dhe monitorimin e reformës, por edhe të decentralizimit, është pikërisht ndërhyrja ligjore, aty ku mund të përmirësohet më shumë, në ligjin nr. 139 të përfaqësimit.

Duke folur për decentralizimin, ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë një vëmendje e shtuar e strategjisë. Unë e thashë pak më parë se strategjia sektoriale vijon dhe ndiqet si proces nga Ministria e Brendshme në hartimin e programit 2023-2030 dhe njësitë vendore të mëdha, të konsoliduara financiarisht dhe me burime të mjaftueshme njerëzore, që përfitojnë më shumë nga procesi i decentralizimit, prandaj të copëtosh edhe më tej territorin është në kundërshtim me këtë parim bazë të decentralizimit. Konsolidimi i ushtrimit të funksioneve të decentralizuara dhe decentralizimi i funksioneve të reja nevojitet të ecin paralelisht me qëllimin e mosmbingarkimit të bashkive me funksione dhe kompetenca që nuk mund t'i ushtrojnë dot. Decentralizimi asimetrik apo delegimi i kompetencave është parë, gjithashtu, si një instrument për mosndërprerjen e procesit të decentralizimit.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Përgjatë veprimtarisë së komisionit është shtruar disa herë pyetja: a duhen shtuar më shumë bashki apo duhen pakësuar? Po ashtu, është shtruar pyetja: a është ky momenti për të parë këtë çështje? Cilat argumente i afrohen realizimit të objektivave të synuara në reformën administrativo-territoriale të vitit 2014 dhe si do të ndikonte një copëtim i mëtejshëm i territorit, siç e thashë pak më parë, për moskthimin mbrapsht? Ne, si anëtarë të komisionit, përfaqësues të maxhorancës, kemi diskutuar edhe disa kritere jo vetëm si një objekt të veprimtarisë së komisionit, por edhe si një nevojë për të parë se cila do të ishte përgjigjja e këtyre pyetjeve, duke ruajtur në veçanti vlerësimin për propozime. Asnjë gjë nuk është diçka që nuk mund të ndryshohet dhe të mos ketë kohë, në fakt, për të mos analizuar një reformë, edhe pse 7 vjet janë të pamjaftueshëm, por asnjë gjë nuk është aty për të mos u analizuar dhe për të mos u ndryshuar, por kriteret vendosin nëse është ky momenti dhe nëse do të sjellë përmirësime.

Duke ruajtur këto kritere, si më poshtë:

- të jetë qendër e një zone funksionale, (këtu dua të kujtoj se zonat funksionale kanë qenë kriteri bazë i reformës administrativo-territoriale në vitin 2014);

- të ketë qenë bashki para ndarjes territoriale të vitit 2015, me qëllim garantimin e qenies së një zone urbane që ka kapacitet dhe mundësi për ofrimin e shërbimeve administrative dhe publike, (kriter që do të mbështeste faktin që shpëputja nga bashkia, pra krijimi i një njësie të re, nuk do të dëmtojë zhvillimin e ekonomisë së njësisë nga e cila shpëputet);

- të ketë numër popullsie të caktuar për të garantuar që shërbimet e decentralizuara të vijojnë të konsolidohen, të jetë e garantuar mbështetja me staf të kualifikuar dhe numri i bizneseve dhe i komunitetit të biznesit të jetë po aq i rëndësishëm dhe i përfaqësuar në këto zona të reja.

Sigurisht, unë e thashë pak më parë që ne duhet t'i bëjmë shpesh këto pyetje, jo vetëm në këto momente, por nuk duhet të bëjmë gabime në dhënien e përgjigjeve të këtyre pyetjeve. Në prezantimin e raportit nga opozita, ku numri prej 94 njësisish të vetëqeverisjes vendore nuk u përshtat me asnjë nga këto kritere, sigurisht, i mbetemi objektivave të reformës administrativo-territoriale për të mos u kthyer pas me problemet, por për t'u konsoliduar më tej dhe për të përmirësuar elementet që ende kanë nevojë për vëmendje, siç e thashë pak më parë: përfaqësimi, shërbimi dhe decentralizimi i funksioneve.

Ka gjithmonë një diskutim nëse bashkitë e mëdha apo të vogla janë të suksesshme në atë që është reforma e përgjithshme e administrimit. Sigurisht, për mua si financiere, kur flasim shifrat dhe faktet e financave, bashkitë e mëdha dhe të vogla prevalojnë. Ne nuk mund të bëjmë gabimin që bashkitë e

vogla, të cilat përfaqësojnë shumë më mirë vlerat kulturore, komunitete, sidomos kur edhe në këshillim ne dëgjuam një numër të konsiderueshëm të përfaqësuesve të minoriteteve, të mos marrim parasysh këto elemente dhe të mbetemi vetëm te kriteri financiar, prandaj, nëse një logjikë e pastër financiare dhe ekonomike do të ishte për uljen e numrit të bashkive dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, duke marrë për bazë elementet që thamë pak më parë, përfaqësuesit e maxhorancës në këtë komision i qëndrojnë numrit prej 61 bashkish apo njësi të vetëqeverisjes vendore.

Gjithsesi, në çdo rast, jo vetëm për këtë seancë plenare me diskutimet dhe debatet në vijim, por për çdo komision që mund të ngrihet në vijim për të analizuar numrin e njësive të vetëqeverisjes vendore, mbetet sërish diskutimi dhe pyetjet: A do të mund të ketë çdo pjesë e krijuar si bashki më vete një qendër ofrimi shërbimesh publike? A ka kjo pjesë popullsi të mjaftueshme? A garanton secila cilësi shërbimesh? A ka çdo pjesë e re mjetet dhe pajisjet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve? A e dëmton ndarja e re administrative territoriale procesin e realizuar më parë? Cilat (kjo mbetet e pazbuluar nga raporti që kemi dëgjuar më parë), janë mundësitë që u janë shtuar këtyre njësive të vogla, krahasuar me njësitë e mëdha, për të realizuar të ardhurat dhe investimet e synuara në shërbim të qytetarëve?

Reforma administrative territoriale e vitit 2014, e thashë edhe pak më parë, i ka përmbushur objektivat për të cilët u realizua, njëkohësisht, ka realizuar edhe pritshmëritë e komunitetit të gjerë. Arritjet e deritanishme dhe përvoja e fituar janë një garanci për konsolidimin e mëtejshëm të problematikave, që janë evidentuar për 61 njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe për garantimin e shërbimeve më të mira, me efektivitet dhe eficiencë më të lartë në të gjithë territorin e vendit. Siç e thashë, maxhoranca në këtë komision propozon përmirësime të mëtejshme ligjore dhe mundësinë e krijimit të mekanizmave dhe instrumenteve efektive për të garantuar një mbështetje më të madhe. Sipas rekomandimeve të paraqitura, i propozohet Ministrisë së Brendshme si mundësi përfshirja e tyre në strategjinë kombëtare ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023 – 2030, që është në proces hartimi, me qëllim konsolidimin e vetëqeverisjes vendore.

Konkretisht ato janë:

- Përfaqësimi i banorëve të njësive administrative dhe i zonave rurale në këshillat bashkiakë mund të përmirësohet nëpërmjet rishikimit të mënyrës së zgjedhjes së këshillave bashkiakë dhe strukturave komunitare.

- Forcimi i rolit të këshillave bashkiakë në mbikëqyrjen dhe rolin e kontrollit të veprimtarisë së ekzekutivit duhet sanksionuar në ligjin organik nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Vijimi i decentralizimit, veçanërisht decentralizimi asimetrik duhet të sigurojë decentralizim funksionesh dhe kompetencash të reja për bashkitë që zotërojnë kapacitetet e nevojshme për administrimin e tyre.
- Shtimi i mbështetjes financiare për bashkitë nëpërmjet shtimit të taksave të ndara, analizë e dedikuar teknike nga ekspertë për aspektin e rritjes së përqindjes së taksave të ndara në favor të bashkive, veçanërisht rentës minerare, por kjo, siç e thashë, duhet të jetë një analizë ekspertësh e mirëstuduar.
- Rritja e kompetencave të administratorëve dhe rolit të njësive administrative, si dhe e strukturave komunitare në ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet delegimit të më shumë kompetencave nga ana e kryetarëve dhe këshillave bashkiakë.
- Rishikimi ose liberalizimi i nivelit të pagave të administratës së bashkive, me qëllim sigurimin e një administrate të aftë dhe të mirëpaguar, duke synuar cilësi dhe jo numër, veçanërisht në bashkitë e vogla.
- Qartësimi i kompetencave të njësive të vetëqeverisjes vendore, me qëllim shmangien e mbivendosjeve me strukturat e decentralizuara vendore. Pikërisht pas një analize të tillë mund të vihet me propozim për rishikimin e qarqeve.
- Plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit sektorial në fushat e funksioneve të bashkive.
- Rishikimi i rolit dhe i kompetencave të qarkut në përputhje me strategjinë e zhvillimit rajonal, si dhe me perspektivën eventuale të afrimit me Bashkimin Europian.
- Përmirësime të tjera që diktohen nga nevoja për një qeverisje vendore të hapur dhe transparente.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, është rritja e monitorimit të performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore në mënyrë konsistente, permanente nëpërmjet shtimit të rolit të agjencisë monitoruese, marrjes së masave në kohë për çdo performancë të munguar për të mos ngatërruar në vijim në performancë analizën e reformës administrative territoriale me atë të pushtetit vendor.

Në përfundim, anëtarët e komisionit, si pjesë e maxhorancës, i rekomandojnë këtij parlamenti:



- Vazhdimin e përpjekjeve të përbashkëta të qeverisë me të gjithë aktorët vendas, qendrorë e lokalë, dhe me partnerët tanë ndërkombëtarë.
- Konsolidimin e 61 njësive të vetëqeverisjes vendore drejt krijimit të bashkive që e realizojnë veprimtarinë e tyre bazuar në parimet e qeverisjes së hapur, në parimin e vetëqeverisjes autonome, që veprojnë në interes të komuniteteve që përfaqësojnë, që mbështesin zhvillimin ekonomik-vendor dhe ofrojnë shërbime cilësore për komunitetin.
- Qartësimin e funksioneve dhe kompetencave të 12 këshillave të qarqeve si njësi vendore të nivelit të dytë me rol të veçantë në zhvillimin rajonal, si dhe garantimin e mbështetjes së nevojave për 12 këshillat e qarqeve për ushtrimin efektiv të veprimtarisë së tyre.
- Konsultimin me komunitetet vendore me të zgjedhurit, me drejtuesit vendorë, si dhe me ekspertë të pavarur për gjetjet dhe nevojat, të cilat në këtë komision erdhën si një domosdoshmëri për të sjellë përmirësimin e mëtejshëm të reformës administrative territoriale të nisur në vitin 2014.
- Trajtimin rast pas rasti nga ana e qeverisë dhe e Kuvendit të kërkesave të veçanta nëse ka rishikim kufijsh nëpërmjet fshatrave për përkatësinë e fshatrave apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve territoriale.

Së fundi, edhe unë, sikurse edhe bashkëkryetarja Çupi, dua t'i falënderoj të gjithë anëtarët e këtij komisioni nga të dyja palët për debatet konstruktive!

Gjithashtu, dua t'i falënderoj të gjithë përfaqësuesit, të cilët erdhën me shifra, me fakte, me kritika dhe me sugjerime jo vetëm nga shoqëria civile, bota akademike, por edhe përfaqësues të grupeve minoritare, pushtetit vendor dhe qendror për të sjellë në këto dëgjesa fakte, shifra dhe për të sjellë në vëmendje të të gjithë parlamentarëve nevojën për të qenë më afër këtyre problemeve, por zgjidhja është ajo që na divergjon. Ne si maxhorancë synojmë vijimin e reformës së domosdoshme të ndërmarrë në vitin 2014, me objektivin e vetëm për të mos t'iu kthyer pas problematikave, për të konsoliduar objektivat e nisura dhe për të vijuar me këta objektiva drejt një suksesi të garantuar dhe jo kthim mbrapa në problematikat e vjetra, të cilat kjo reformë i ka zgjidhur njëherë e përgjithmonë. Faleminderit!